

VENDIM

Datë 11/05/2022

I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË

“E VENTO srl Albania” Sh.p.k.


K81419015N

Sot, më datë 11/05/2022, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë si dhe ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, unë ortaku i vetëm Rexhep Tarba,

VENDOSA:

1. Miratimin e transferimit nëpërmjet shitblerjes të 80% të kuotave nga unë ortaku i vetëm Rexhep Tarba, tek “G.P.G. COMPANY” sh.p.k;
2. Miratimin e transferimit nëpërmjet shitblerjes të 1% të kuotave nga unë ortaku i vetëm Rexhep Tarba, tek z. Florian Peri.

ORTAKU



Rexhep TARBA



KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 11/05/2022, nënshkruhet kjo Kontratë Shit-Blerje Kuotash mes palëve si më poshtë vijon:

PALA SHITËSE:

- Rexhep Tarba, i biri i Fejzulla, i datëlindjes 20/10/1965, lindur në Fushkull dhe banues në adresën Rruga "F. Xhajko" Pallati 66/2, Njësia Administrative Nr.8, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal G51020108W (referuar në vijim si "Pala Shitëse");

PALA BLERËSE:

- Shoqëria "G.P.G COMPANY" sh.p.k, me NUIS J64324443V, adresa: Fier-Lushnje, Lagja 18 Tetori, godinë 1 katëshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, pranë Rotondos së Plukut, përfaqësuar në këtë kontratë nga administratori i shoqërisë Paqsor Buzi, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal H00903078F;
- Florian Peri, i datëlindjes 18/01/1982, lindur në Kuçovë dhe banues në Rrugën "Rreshit Petrela", ndërtesa nr. 2, hyrja 1, njësia administrative nr.9, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal I20118120I;

Pala Shitëse dhe Pala Blerëse në vijim do të referohen bashkërisht si "**Palët**".

PREAMBUL

- Shoqëria "E VENTO srl Albania" sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K81419015N, me seli në adresën Rruga "Myrteza Topi", Ndërtesa Nr.18, Hyrja 7, Apartamenti 38, Tiranë, kapitali i së cilës është i ndarë në 1 (një) kuotë në masën 100%, e zotëruar nga ortaku i vetëm Rexhep Tarba;
- Shoqëria "G.P.G. Company" sh.p.k. ka shprehur interesin për të blerë një kuotë në masën 80% në shoqërinë "E VENTO srl Albania" dhe Z. Rexhep Tarba është shprehur pozitivisht për t'ia shitur një kuotë në masën 80% të kapitalit;
- Z. Florian Peri ka shprehur interesin për të blerë një kuotë në masën 1% të kapitalit të shoqërisë "E VENTO srl Albania" dhe Z. Rexhep Tarba është shprehur gjithashtu pozitivisht për t'ia shitur një kuotë në masën 1% të kapitalit;
- Pala Shitëse deklaron dhe garanton palën Blerëse se është dhe do të jetë deri në momentin e ekzekutimit të kontratës, e pajisur me çdo kapacitet, fuqi dhe autorizim të nevojshëm për të përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin prej kësaj kontrate;
- Pala Shitëse deklaron se nuk ekziston asnjë rrethanë ligjore e çdo lloji që të pengojë realizimin e kësaj Kontrate.

Për sa më sipër, palët bien dakord si vijon:

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është shitblerja e dy kuotave në masën totale prej 81% të kapitalit të shoqërisë “E VENTO srl Albania” sh.p.k. e zotëruar nga ortaku i vetëm i shoqërisë Z. Rexhep Tarba tek shoqëria “G.P.G. Company” sh.p.k. dhe z. Florian Peri.
- 1.2. Shitblerja në masën 81% të kapitalit të shoqërisë “E VENTO srl Albania” sh.p.k. do të realizohet tek Blerësit të cilët janë përkatësisht:
- Shoqëria “G.P.G. COMPANY” sh.p.k, me NUIS J64324443V do të blejë një kuotë në masën 80% të kapitalit; dhe
 - Z. Florian Peri, mbajtes i kartës së identitetit me nr. Personal I20118120I, i cili do të blejë një kuotë në masën 1% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 2

VLERA E SHITJES

- 2.1 Palët kanë parashikuar që vlera totale e shitjes së kuotave të zotëruara nga ortaku i vetëm Z. Rexhep Tarba tek Blerësit është e barabartë me vlerën nominale 81.000 (tetëdhjetë e një mijë) Lekë, respektivisht:
- 80.000 (tetëdhjetë mijë) Lekë do të paguhet nga shoqëria “G.P.G COMPANY” sh.p.k e cila do të blejë një kuotë në masën 80% të kapitalit, dhe;
 - 1.000 (një mijë) Lekë do të paguhet nga z. Florian Peri, i cili do të blejë një kuotë në masën 1% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 3

AFATET

- 3.1 Transferimi i kuotave sipas kësaj kontrate do të publikohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit brenda afateve ligjore.

Neni 4

GARANCITË

- 4.1 Pala Shitëse garanton palën Blerëse se është i vetmi titullar i ligjshëm i dy kuotave në masën totale 81% të kapitalit që po transferon nëpërmjet kësaj Kontrate dhe se këto dy kuota në masën 81% objekt shitje sipas kontratës së shitblerjes, janë të lira, nuk janë të barrësuara në favor të palëve të treta, nuk ka asnjë peng, të drejtë parablerjeje ose çfarëdo lloji të drejte kundrejt palëve të treta.

Neni 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 5.1 Për Palën Shitëse:
- a. Ka të drejtë të paguhet për vlerën e kuotave të shitura sipas nenit 2, në afatet e përcaktuara në nenin 3;

b. Ka detyrim të realizojë të gjithë hapat procedurale për miratimin dhe regjistrimin e shitblerjes, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

5.2 Për Palën Blerëse:

a. Ka detyrim të bëjë pagesën për vlerën e kuotave të blera sipas nenit 2, brenda afatit të përcaktuar sipas nenit 3. Subjektet e Palës Blëse nuk janë të varura nga njëra-tjetra në lidhje me pagesën dhe fitimin e të drejtave mbi kuotat e blera sipas kësaj kontrate.

Neni 6

KONFIDENCIALIETI

6.1 Palët bien dakord që do të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë duke mos shpërndarë apo bërë publike informacionet dhe dokumentet me të dhëna sensitive të shoqërisë.

Neni 7

INTERPRETIMI

7.1 Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

7.2 Secila pjesë e kësaj Kontrate, në çdo rast, do të interpretohet si një e tërë, në kuptimin e duhur duke mos nënkuptuar një interpretim më shtrëngues nga njëra palë kundrejt palës tjetër.

7.3 Në rast se një ose disa nga parashikimet e përfshira në këtë Kontrate rezultojnë të pavlefshme, tërësisht ose pjesërisht, pjesa tjetër e parashikimeve të Kontratës mbetet e vlefshme. Klauzolat e pavlefshme duhet të interpretohen apo zëvendësohen në mënyrë të tillë që të arrihen sa më shumë që të jetë e mundur qëllimet fillestare të Palëve.

Neni 8

MOSMARRËVESHJET

8.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Kontrate, që rrjedh nga kjo Kontratë, ose që lidhet me të, nëse nuk do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9

HYRJA NË FUQI

9.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

9.2 Regjistrimi i transferimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi.

Neni 10

DISPOZITA TË FUNDIT


10.1 Kjo Kontratë përcaktohet në përputhje me dispozitat e së drejtës shqiptare dhe për çështje që nuk rregullohen në mënyrë specifike nga kjo kontrate, Palët do t'i referohen legjislacionit shqiptar në tërësinë e tij.

10.2 Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen e Palëve dhe mbizotëron mbi çdo marrëveshje ose kontratë të mëparshme, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me çështjet e përfshira në këtë Kontratë.

10.3 Kjo Kontratë do të hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale.

PALET NË KONTRATË:


PALA SHITËSE:


Rexhep Tarba

PALA BLERËSE:


Shoqëria "G.P.G. COMPANY" sh.p.k
Paqsor Buzi




Florian Peri